



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Dokument Politikash

Procesi i konsultimit në Shqipëri në kuadër të integritit evropian roli i shoqërisë civile

Dokument Politikash

Procesi i konsultimit në Shqipëri në kuadër të integritit evropian – roli i shoqërisë civile

Ky studim u përgatit nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

Design and Layout
Kristina Lato

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile



info@resourcecentre.al



www.resourcecentre.al

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,
Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1
Kodi Postar 1010, Tirana, Albania
Tel: +355 4 2254881

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	06
Konteksti dhe vlerësimi i ligjit për konsultimin publik në Shqipëri	09
Rast praktik: draft ligji “Mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.	11
Procesi i konsultimit publik për projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”	12
Vlerësimi i strukturave të konsultimit dhe zhvillimit të tyre	13
Platforma e partneritetit për Integrimin European	14
Mekanizmat këshillues nga Kuvendi i Shqipërisë	18
Rekomandimet e shoqërisë civile për procesin e konsultimit	22
Drejtuar strukturave shtetërore dhe platformave të konsultimit	22-23
Për aktorët e Shoqërisë Civile	24
Bibliografia	25

Lista e shkurtimeve

FATF – Task-Forca e Veprimit Financiar

GNPIE - Grupet Ndër-Institucionale të Punës për Integrimin European

INSTAT - Instituti i Statistikave

KE - Komisioni European

KKIE - Këshilli Kombëtar i Integritetit European

MB - Ministria e Brendshme

MEPJ - Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme

MFE - Ministria e Financave dhe Ekonomisë

MFE - Ministry of Finance and Economy

MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit Terrorist

NUIS - Numri Unik i Identifikimit të Subjektit

OJF - Organizatë jofitimprurëse

OSHC - Organizatë e Shoqërisë Civile

PKIE - Plani Kombëtar për Integrimin European

PPIE - Platforma e Partneritetit për Integrimin European

Hyrje

Vitet 2020 dhe 2021 ishin vite të vështira për sektorin e shoqërisë civile, ashtu siç ishin edhe për të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë dhe shoqërisë, për shkak të pasojave dhe kufizimeve të pandemisë Covid-19. Mirëpo edhe nën këto kufizime, qoftë fizike apo financiare, ky sektor bëri të gjitha përpjekjet e nevojshme për të përmbushur funksionet e tij dhe ka qenë i angazhuar në veprimtari me ndikim të prekshëm e të targetuar për të mbështetur grupet që u prekën më shumë nga pandemia. Nga ana tjetër, është e rëndësishme të nënvizohet se gjatë kësaj kohe nga institucionet shtetërore nuk është dhënë asnjë mbështetje financiare apo teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC). Megjithatë qeveria shqiptare ofroi mbështetje financiare për sektorin e biznesit dhe familjet në nevojë, ajo la jashtë këtyre skemave sektorin e shoqërisë civile. Kështu, ky sektor dhe veçanërisht OSHC-të grassroot u përballën me pengesa të mëdha në një situatë ku të gjitha aktivitetet social-ekonomike dhe civile ishin ndaluar plotësisht apo ishin kufizuar.

Edhe pas heqjes së kufizimeve nuk u lejuan aktivitetet dhe grumbullimet, gjë që ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në punën e përditshme të organizatave. Pa marrë asnjë mbështetje nga shteti, ndërkohë që kostot vazhdonin të ishin pothuajse në të njëjtin nivel dhe duke marrë në konsideratë pasojat negative që pati shkaktuar tërmeti shkatërrues i nëntorit 2019, funksionimi normal i OSHC-ve u vu në pikëpyetje. Përgjatë kësaj periudhe burimet e vetme financiare dhe mbështetja teknike erdhi nga donatorët ndërkombëtarë, si dhe nga thirrjet e ndryshme ad-hoc që u shpallën për të mbështetur organizatat duke ofruar trajnime dhe aktivitete për rritjen e kapaciteteve, me qëllim përshtatjen me situatën e re, si: (shfrytëzimi i medias dhe teknologjisë; smart-working; zhvendosja e aktiviteteve online etj.). Megjithatë, këto grante ad-hoc nuk qenë të mjaftueshme, për shkak të numrit të madh të organizatave që kishin nevojë për këtë mbështetje.

Në Shqipëri që prej vitit 2019 është miratuar Udhërrëfyesi për Hartimin e Politikës dhe Masave për një Mjedis Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, për periudhën 2019-2023. Mirëpo, zhvillimet thelbësore dhe mbështetja që ky udhërrëfyes synon t'i ofrojë sektorit të shoqërisë civile nuk janë ende të dukshme. Raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2020 ka vlerësuar se “nuk ka progres[1]” të bërë përgjatë vënies në zbatim të këtij udhërrëfyesi, ndërkohë që në vitin 2021 hasim një zhvillim të lehtë pozitiv, ku zbatimi i udhërrëfyesit po nga ky raport vlerësohet me “progres të kufizuar[2]”.

[1] Raporti i KE për Shqipërinë 2020 fq. 12-13: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

[2] Raporti i KE për Shqipërinë 2021 fq. 13: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Hyrje

Sidoqoftë, raporti i KE për vitin 2021 vlerëson si problematik faktin që udhërrëfyesi “mbetet i varur nga mbështetja e donatorëve[3]” dhe që “zbatimi i masave të tij është i ngadaltë dhe deri tani nuk ka pasur asnjë ndikim në sektor”[4].

Sidoqoftë, për vitin 2021 është shënuar një tjetër shenjë progresi në kuadër të forcimit të OSHC-ve dhe të sektorit në përgjithësi, duke mundësuar mjetet dhe kushtet për një funksionim më efektiv dhe bashkëpunim mes vetes dhe sektorëve të tjerë, më specifikisht me institucionet shtetërore.

Në qershor 2021 është miratuar “Ligji për Regjistrimin e Organizatave jofitimprurëse” i vlerësuar nga raporti i KE për Shqipërinë 2021 si një ligj që “sjell disa përmirësime”. [5] Ky ligj synon të rrisë transparencën e OJF-ve duke prezantuar një regjistër elektronik për ta bërë më të lehtë procesin e regjistrimit të tyre, si edhe më të saktë duke përvetësuar Planin e Veprimit të Task-Forcës së Veprimit Financiar[6] (FATF) që është pjesë e një prej kapitujve kryesorë të BE-së, më konkretisht e Kapitullit 24 – Drejtësia, Siguria, Liria. Pavarësisht nga sfidat dhe kufizimet financiare përgjatë Covid-19, procesi i konsultimit ka vazhduar më së shumti me aktivitetet e zhvendosura online, ku pjesëmarrësit janë angazhuar nëpërmjet platformave të ndryshme dhe komunikimi është bërë përmes e-maileve.

Në Shqipëri e drejta për informim dhe procesi i konsultimit publik rregullohet nga dy ligje të miratuar në 2014, Ligji Nr. 146 “mbi Konsultimin Publik” dhe Ligji Nr. 119 “mbi Të Drejtën për Informim[7]”.

Ligji mbi konsultimin publik përcakton procedurën që ndiqet me qëllim kryesor lejimin e një pjesëmarrjeje publike gjithëpërfshirëse e transparente, duke marrë në konsideratë standardet europiane.

Për më tepër, për konsultimin publik është hartuar një platformë online[8] që ofron informacion mbi projektligjet, politikat dhe dokumentet që duhen konsultuar; gjithashtu ofron mundësi për këdo që akseson këto akte e dokumente, që të japë sugjerime dhe komente. Bazuar në Ligjin 146/2014 autoritetet publike janë të detyruara të përgatisin dhe të publikojnë raportet vjetore të transparencës mbi procesin e vendimmarrjes.[9]

[2] Ibid, fq. 13-14

[3] Ibid, fq. 13-14

[4] Ibid, fq. 13

[5] Më shumë për publikimet dhe raportet e monitorimit të FATF për Shqipërinë: <https://www.fatf-gafi.org/countries/#Albania>

[6] Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” <https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

[7] Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” <https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

[8] Adresa zyrtare e kësaj platforme: <https://konsultimipublik.gov.al/>

[9] Akti 6, Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” <https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

Hyrje

Informacioni që duhet të përfshihet konsiston në: numrin e akteve të miratuara, totalin e numrit të rekomandimeve, numrin e pranuar dhe të refuzuar të rekomandimeve, si dhe numrin e takimeve publike të organizuara për aktet në fjalë. Këto raporte janë publikuar në sektorin e dedikuar për konsultimet publike në regjistrin elektronik[10].

Raporti i publikuar për gjysmën e parë të vitit 2021, vlerëson se 13 nga 14 akte të konsultuara janë publikuar në këtë platformë[11]. Gjithashtu është vlerësuar pozitiv miratimi i udhëzimit dhe monitorimi i kuadrit të konsultimit publik, që ka si qëllim përmirësimin e marrëveshjeve shtetërore për një zbatim më të mirë të ligjit. Për të njëjtën periudhë kohe, kanë kontribuar në total 144 sektorë jo-shtetërorë dhe përgjatë aktiviteteve të konsultimit publik janë marrë 150 komente. Vihet re se pothuajse gjysma e pjesëmarrësve është angazhuar për të ofruar kontribute dhe komente. Projektligji me më shumë komente është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2023, me 60 komente të përgjithshme dhe numri i kontributeve është më i lartë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni kryesor për këtë strategji. Nga institucionet janë pranuar plotësisht pothuajse 65% e numrit total të komenteve, ndërkohë që 18% e tyre nuk janë marrë në konsideratë, dhe pjesa e mbetur do të thotë që janë marrë në konsideratë vetëm pjesërisht[12].

Përpos zhvillimeve të tilla, Raporti i KE për 2021-in vlerëson se procesi i konsultimeve në shumicën e rasteve qëndron si një praktikë e pafrytshme dhe që ligji 146/2014 ka nevojë të përditësohet dhe të ndryshohet bazuar në zhvillimet dhe ndryshimet kryesore në procesin e vendimmarrjes. Më saktësisht, rreth 30% e të gjithë projektligjeve nuk janë konsultuar me asnjë grup interesi përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021, ndërkohë që kjo përqindje ka qenë më e ulët për të gjithë vitin 2020 (20% e projektligjeve nuk janë konsultuar)[13].

Projektligji i sipërpërmendur “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” ishte nën konsultime paraprake për një periudhë dy mujore, ku u vendos për metodat e shtjellimit të mëtejshëm dhe u identifikuan grupet e interesit. Për më tepër, komentet dhe sugjerimet u morën përmes tryezave të organizuara nga Ministria e Drejtësisë me përfaqësues nga qeveria, shoqëria civile dhe grupe të tjera interesi. Një proces i mbyllur konsultimi u zhvillua kur projektligji u vendos në portalin e regjistrat elektronik për 20 ditë pune, ku u morën 32 komente. Përveç pyetjeve teknike, shoqëria civile ishte mjaft e shqetësuar për përmbajtjen e neneve të aktit.

[10] Raportet Vjetore të transparencës të publikuara nga autoritetet publike në regjistrin elektronik:

<http://www.konsultimipublik.gov.al/Raporte2021>

[11] Raporti i performancës për Konsultimin Publik (gjysma e 2021):

https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/RaportiiPerformancesKonsultimitPublik_CoG_30.07.2021.pdf

[12] Raporti i performancës për Konsultimin Publik (gjysma e 2021):

https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/RaportiiPerformancesKonsultimitPublik_CoG_30.07.2021.pdf

[13] Ibid, fq. 12

Konteksti dhe vlerësimi i ligjit për konsultimin publik në Shqipëri

Praktika e konsultimit publik për projektligjet dhe dokumentet strategjike është sine qua non, në mënyrë që të forcohet legjitimiteti dhe efikasiteti i institucioneve demokratike. Sektori i shoqërisë civile në Shqipëri është përpjekur vazhdimisht të sigurojë qëndrueshmëri afatgjatë dhe përfshirje në vendimmarrje. Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, i miratuar më 30 tetor 2014 me elemente që rrisin transparencën, nxisin pjesëmarrjen dhe lehtësojnë palët e interesuara që të vlerësojnë punën e autoriteteve publike. Objektivi kryesor i ligjit është të rregullojë procesin e njoftimeve dhe konsultimit publik, si dhe të vendosë rregulla procedurale në mënyrë që të garantojë pjesëmarrje më të gjerë dhe transparencë.

Detyrimet kryesore të autoriteteve publike janë përcaktuar në Artikullin 6 të Ligjit Nr. 146/2014 dhe konsistojnë në: publikimin e projektligjit në regjistrin elektronik për konsultimin publik; detaje të tjera me rëndësi lidhur me njoftimet, dhënia e informacionit mbi të gjitha fazat e konsultimit publik (publikimi i projektligjit, komentet e marra, organizimi i konsultimeve publike dhe përshtatja përfundimtare e akteve). Takimet mund të organizohen pas publikimit të projektligjit në regjistrin elektronik për konsultim publik.

Një element thelbësor është marrja e komenteve dhe rekomandimeve nga palët e interesuara. Këto komente mund të dërgohen përmes një larmie metodash si: me shkrim në regjistrin elektronik për konsultimin publik; përmes e-mail-it, gjatë takimeve publike etj., brenda 20 ditëve punë (ashtu sikurse është vendosur nga ligji).[14]

Në raste specifike kur janë akte të ndërlikuara ose me një rëndësi domethënëse, ky afat mund të zgjatet deri në 40 ditë pune. Komentet e marra duhen shqyrtuar dhe vlerësuar nga autoritetet përgjegjëse publike, të cilat kanë për detyrë të vendosin se cilat komente do të merren në konsideratë dhe cilat jo. Në rastet kur komentet dhe sugjerimet refuzohen, autoriteti publik është i detyruar të përgatisë arsyet e këtij refuzimi.

[14] Akti 15, Ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” <https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

Konteksti dhe vlerësimi i ligjit për konsultimin publik në Shqipëri

Opinionimi mund të jepet përmes një sërë mekanizmash demokratikë dhe kjo formë ndarjeje hegjemonie mes qytetarëve dhe institucioneve është lehtësuar përmes regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimin publik:

<https://konsultimipublik.gov.al/>. Procesi i konsultimit publik vlerëson që pjesëmarrësit do të vijnë nga pozita të ndryshme, me larmi eksperiencash dhe do ta përshtatin dhe përditësojnë aktin juridik në mënyrë të dobishme. Është synuar që ky të jetë një proces ndërveprues që nxjerr në pah prioritetet dhe interesat e larta të qytetarëve gjatë politikëbërjes.

Regjistri ofron informacion objektiv dhe udhëzime për të ndihmuar palët e interesuara të kuptojnë përmbajtjen e dokumentit ligjor dhe ofrimin e rekomandimeve. Portali i regjistrit elektronik për konsultime publike është i ndarë në fraksione të ndryshme dhe individët mund të kontribuojnë si qytetarë ose ekspertë të fushave të ndryshme. Ata gjithashtu mund të zgjedhin një institucion specifik që ka nxjerrë për shqyrtim draftet ose ka hapur votim. Ky proces mund të jetë i hapur apo i mbyllur, në varësi të rëndësisë së informacionit që ka nisur të ndahet në përputhje me legjislacionin ekzistues. Grupet e interesit mund të vetëidentifikohen dhe të ngarkojnë sugjerimet e tyre duke respektuar afatin e dërgimit. Ky ndërveprim i zhvilluar online siguron që shqetësimet dhe pritshmëritë e publikut të merren në konsideratë në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet, duke qenë se synimi përfundimtar është që vendimmarrja të mbetet në duart e qytetarëve. Në këtë mënyrë, hapësira virtuale i kapërcen dhe kufijtë gjeografikë. Ndërkohë që raporti kryesor për vitin 2021 nuk është publikuar ende, është me rëndësi thelbësore të theksohet se raporti për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 tregon se: të gjitha ministritë raportuan 267 pjesëmarrës, ku 54% e tyre morën pjesë në mënyrë aktive duke dhënë komentet e sugjerimet e tyre. Në këtë linjë, shkalla e pranimit për rekomandimet e dhëna ishte 82.66%.

Rast praktik: draft ligji “Mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Ky projektligj u ngarkua në regjistrin elektronik për konsultim publik nga Këshilli i Ministrave më 10 qershor 2020.[15]. Qëllimi i tij kryesor ishte ndryshimi i Ligjit Nr. 8789/2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe konvertimi i sistemit të regjistrimit nga manual në elektronik. Ky veprim synon të thjeshtojë dhe të rrisë transparencën me procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse (OJF) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Baza e të dhënave planifikohet që të përditësohet elektronikisht dhe të mbledhë e të organizojë të dhënat për organizatat e shoqërisë civile që zhvillojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë. Krijimi dhe mbajtja e regjistrit elektronik për OJF-të u rekomandua nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit Terrorist (MONEYVAL).

Synimi ishte përfshirja e të dhënave të rregulluara me ligj si: krijimi, aktiviteti, çregjistrimi i OJF-ve, ndryshimi i statutit, organizimi i tyre dhe përfaqësimi. Ndryshimet hynë në fuqi pas miratimit të projektligjit më 24 qershor 2021. Ligji nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse[16]” specifikon se kërkesa për regjistrim bëhet me shkrim ose online në Gjykatën e Rrethit të Tiranës. Ministri i Drejtësisë është përgjegjës për miratimin e formularit të aplikimit, regjistrimin në regjistër, ashtu sikurse dhe për listën e dokumenteve shoqëruese sipas ligjit në fuqi. Veç të tjerave, OJF-të janë të detyruara t’i ngarkojnë të gjitha dokumentet e kërkuara për regjistrimin brenda 30 ditëve kalendarike të themelimit. Kjo procedurë konsiston në një akt zyrtar për autoritetet publike dhe sipas ligjit në fuqi individët që i ofrojnë këto të dhëna mbajnë përgjegjësi për vërtetësinë e tyre. Nëse kushtet për regjistrimin nuk janë përmbushur, rishqyrtimi i kërkesës shtyhet për 21 ditë kalendarike. Regjistrimi administrohet nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

[15] Mund ta gjeni raportin këtu:

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_272_Raporti%20i%20Konsultimit%20Publik%20per%20OJF.docx

[16] Mund ta gjeni ligjin e publikuar në fletoren zyrtare këtu:

<https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/ligj-nr.-802021-dt.-24.6.2021.pdf>

Procesi i konsultimit publik për projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”

Konsultimet në portalin online të regjistrimit elektronik të konsultimit publik zgjatën për 20 ditë pune (10.06.2020 - 08.07.2020). Një tjetër metodë e zgjedhur me qëllim diskutimin mbi projektligjin ishin tryezat konsultuese të organizuara nga Ministria e Drejtësisë me palët e interesuara që u takuan maj 2022 dhe korrik 2020. Për më tepër, drafti u konsultua dhe me Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile më 21.07.2020. Sugjerimet e dërguara në regjistrin elektronik, ato të dërguara me postë, si dhe ato të nxjerra nga tryezat konsultuese u pranuan ose refuzuan bazuar në argumente. Një grup OJF-sh, në total 26 kanë bërë komentet e tyre për 49 akte dhe përmbajtjen e përgjithshme të projektligjit[17]. U konstatua se projektligji përmban disa paqartësi dhe shkon përtej fushës së tij të veprimit, duke përfshirë elemente që duket të jenë të orientuar drejt kontrollimit të OJF-ve. Rekomandimet u realizuan duke marrë në konsideratë parimet thelbësore dhe analizën e çdo neni.

Sugjerimet lidhur me më shumë se 12 ndryshime të konsideruara si thelbësore nuk u pranuan, ndërkohë që vetëm dy rekomandime u reflektuan në projektligj dhe vetëm një u pranua pjesërisht. Kërkesat për Nenin 5, pika 2 për më shumë referenca ligjore për miratimin e formës së aplikimit dhe dokumenteve shoqëruese nga Ministri i Drejtësisë u pranuan. Sugjerimet për Nenin 7, pika 1, lidhur me llojin e subjekteve që kanë të drejtë të regjistrohen u pranuan dhe u reflektuan në përkufizimin e subjekteve jofitimprurëse, duke dhënë shembuj specifikë. U pranuan dhe u sqaruan pjesërisht propozimet për Nenin 49, që trajton të dhënat që administrata tatimore do t'i japë gjykatës. Për sa i përket përmbajtjes së përgjithshme të projektligjit, u kërkua një akt plotësues për të shpjeguar qëllimin kryesor të këtij ligji dhe më shumë detaje shpjeguese lidhur me objektivat specifike të tij. Disa sugjerime teknike u bënë rreth përkufizimit të termave dhe përfshirjes së koncepteve specifike si: (komunikim elektronik, NUIS etj.) në projektligj.

Këto sugjerime u refuzuan dhe u konsideruan të papërshtatshme për t'u përfshirë. Për regjistrin elektronik të OJF-ve janë ngritur shumë pyetje lidhur me përdorimin e të dhënave dhe sigurinë, dhe rekomandimet për tu bazuar në ligjin mbi komunikimin elektronik u pranuan. Reagimi i përgjithshëm kundrejt sugjerimeve nuk ishte pozitiv dhe dështoi në përmbushjen e kërkesave nga shoqëria civile. Deri tani, regjistri elektronik për OJF-të nuk është ende funksional.

[17] Raportin mund ta gjeni këtu: https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_272_Raporti%20i%20Konsultimit%20Publik%20per%20OJF.docx

Vlerësimi i strukturave të konsultimit dhe zhvillimit të tyre

PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Platforma e Partneritetit për Integrimin European (PPIE) është ngritur me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 113, datë 30.08.2019 "Për Format e Pjesëmarrjes, Funksonimin dhe Strukturën Institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin European". Platforma ka në përbërje të saj dy struktura: 33 Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit dhe Bordin Drejtues të Platformës. Bordi është parashikuar të ketë 15 anëtarë, ku 10 prej tyre do të vijnë nga anëtarësia e tryezave nëpërmjet votës së të gjithë anëtarëve të Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit.[18]

Për të bërë të mundur përzgjedhjen e këtyre anëtarëve, është kusht parësor që të gjitha Tryezat të jenë të ngritura, duke qenë që kjo nuk ka ndodhur ende, sjell si rrjedhojë që Bordin të mos jetë ngritur, dhe njëkohësisht dhe vetë Platforma, të jetë ende e paplotësuar dhe jo-plotësisht funksionale.[19] Deri më tani nga të dhënat e marra janë ngritur Tryezat për 20 kapituj, ndërkohë që janë në proces të krijimit edhe tryezat për 9 kapituj të tjerë. Për pjesën e mbetur të tryezave (4) nuk ka informacion se kur pritet të fillojë procesi i ngritjes së tyre.

Për themelimin e këtyre tryezave institucionet përgjegjëse kanë ndjekur në më të shumtën e rasteve të njëjtën procedurë, sipas hapave të renditura më poshtë:

- 1) Shpallja e thirrjes së hapur për aplikime online në faqet zyrtare, por ka dhe raste kur janë përdorur rrjetet sociale apo informimi me e-mail;
- 2) Vlerësimi i aplikimeve të ardhura;
- 3) Njoftimi i aplikantëve për vlerësimin dhe rezultatin e përzgjedhjes;
- 4) Organizimi i takimit të parë me anëtarët e Tryezës.

Procesi për ngritjen e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit fillon me shpalljen e thirrjes për aplikime, ndjekur nga vlerësimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e aplikantëve si anëtarë të Tryezës. Tryeza konsiderohet si e ngritur plotësisht në momentin kur aplikantët e përzgjedhur janë njoftuar që janë tashmë anëtarë të Tryezës.

[8]Urdhri Nr. 113 i KM, datë 30.08.2019 "Për Format e Pjesëmarrjes, Funksonimin dhe Strukturën Institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin European" - <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/01-Urdhri-i-KM-Nr.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

[19]Lista e 35 kapitujve të Acquis së BE: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en - Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit po ngrihen në mënyrë analoge me këto kapituj

Institucioni koordinues	Kapitujt që koordinon	Procesi i ngritjes së Tryezës së PPIE[20]
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Kapitulli 1,3,4,6,7,16,20,28,29,30,32 Kapitulli 2 dhe 33	Ngritur Në proces
Ministria e Drejtësisë	Kapitulli 23	Ngritur
Ministria e Brendshme	Kapitulli 22 Kapitulli 24	Ngritur Ngritur
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Kapitulli 11 dhe 12 Kapitulli 13	Ngritur Nuk është Ngritur
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Kapitulli 25 dhe 26	Ngritur
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Kapitulli 19	Ngritur
INSTAT	Kapitulli 18	Ngritur
Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme	Kapitulli 31	Në proces
Ministria për Turizmin dhe Mjedisin	Kapitulli 27	Në proces
Agjencia e Prokurimit Publik	Kapitulli 5	Në proces
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Kapitulli 10,14,15 dhe 21	Në proces
Autoriteti i Konkurrencës	Kapitulli 8	Nuk është Ngritur
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Kapitulli 9	Nuk është Ngritur
Banka e Shqipërisë	Kapitulli 17	Nuk është Ngritur
TOTALI	20 Tryeza 9 Tryeza 4 Tryeza	Janë ngritur Në proces Nuk janë ngritur

[20] Ngritur – tryeza konsiderohet e ngritur në momentin kur aplikimet janë marrë dhe aplikantët e përzgjedhur janë njoftuar
Në proces – tryeza konsiderohet në proces kur thirrja për aplikime është ende e hapur ose kur përzgjedhja e aplikantëve nuk është përfunduar ende
Nuk është ngritur – tryeza konsiderohet se nuk është ngritur kur thirrja për aplikime nuk është shpallur dhe kur nuk ka asnjë progres

Vlerësimi i strukturave të konsultimit dhe zhvillimit të tyre

PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Sipas Urdhrit Nr. 113, çdo Tryezë Diskutimi dhe Këshillimi kryesohet nga kryetari i Grupit Ndër-Institucional të Punës për Integrimin Europian (GNPIE) për të njëjtin kapitull që është ngritur dhe Tryeza.[21] Ministritë në Shqipëri koordinojnë 27 kapituj të Acquis së BE, ndërkohë që pjesa tjetër e kapitujve koordinohen nga institucione të tjera publike apo agjenci. Më konkretisht, INSTAT është institucioni koordinues për Kapitullin 18 – Statistikat; Banka e Shqipërisë për Kapitullin 17 – Politikën Ekonomike dhe Monetare; Agjencia e Prokurimit Publik është përgjegjës për Kapitullin 5 – Prokurimet Publike; Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për Kapitullin 9 – Shërbimet Financiare; dhe Autoriteti i Konkurrencës për Kapitullin 8 me fokus Politikën e Konkurrencës.[22] Në rastet kur kapitujt koordinohen nga ministritë, si kryetarë të GNPIE dhe rrjedhimisht dhe kryetarë të Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit, janë vendosur zv. ministrat, ku në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 422, i datës 06.05.2020 përcaktohet ndër të tjera jo vetëm roli dhe funksioni i Grupit negociator dhe Kryenegociatorit, por është përcaktuar dhe lista nominale e negociatorëve për të 33 kapitujt.[23]

Bazuar në numrin e kapitujve që një institucion koordinon është vendosur dhe numri i negociatorëve dhe sa kapituj ka në përgjegjësi një negociator. Kështu nuk mungojnë rastet ku negociatorët koordinojnë më shumë se një kapitull, si dhe raste kur për një institucion përgjegjës ka dy apo më shumë negociatorë të cilët ndajnë kapitujt e atij institucioni mes tyre.

Për më tepër, Vendimi Nr. 746 i datës 09.12.2021[24] solli disa ndryshime dhe shtesa të VKM Nr. 422. Vihet re që Kapitulli 22 – Politika Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore deri më tani i koordinuar nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kalon nëpërmjet këtij vendimi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Brendshme (MB). Me këtë ndryshim, MB është tashmë institucion koordinues për dy kapituj të Acquis së BE, Kapitulli 22 dhe atë 24 – Drejtësi, Siguri, Liri. Një tjetër përditësim është në lidhje me negociatorin e Kapitullit 24, i cili ka ndryshuar. Një ndryshim i dukshëm lidhet dhe me ndarjen që u është bërë kapitujve që koordinohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. MFE është institucioni me barrën më të rëndë sa i përket numrit të kapitujve që koordinon, gjithsej 12 kapituj plus Kriterin Ekonomik. Këto kapituj ishin ndarë mes katër zëv. Ministrave të MFE, ndërkohë që VKM e 2021 i ndan ato mes tre zëv. Ministrave. Ajo që vihet re është që një zëv-ministër tanimë është kryetar për shtatë kapituj 1,2,3,6,7, 20 dhe 30 dhe bashkë-kryesues i dy kapitujve: Kapitulli 19 – Politikën Sociale dhe të Punësimit dhe Kapitulli 28 – Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit Publik.[25]

[21] Urdhri Nr. 113 i KM, datë 30.08.2019 "Për Format e Pjesëmarrjes, Funksionimin dhe Strukturën Institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian"- <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/01-Urdhri-i-KM-Nr.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

[22] VKM Nr. 422, datë 6.5.2020 "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" - <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/98/9627cbf1-a528-4e11-8a6a-597b16cfaae2>

[23] Ibid

[24] VKM Nr. 746 datë 09.12.2021 mbi disa ndryshime për Vendimin Nr. 422, datë 6.5.2020 "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", i ndryshuar - <https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-9-dhjetor-2021/>

[25] Kapitulli 19 dhe Kapitulli 28 – janë dy kapituj që koordinohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vlerësimi i strukturave të konsultimit dhe zhvillimit të tyre

PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Për tu shtuar është dhe fakti që Kapitulli 4 -Lëvizja e lirë e Kapitalit, me vendimin e 2021 i ka kaluar në përgjegjësi MFE, ndërkohë që me vendimin e kaluar ishte Banka e Shqipërisë institucioni udhëheqës për këtë kapitull. Në kuadër të zhvillimeve të Platformës së Partneritetit dhe tryezave tashmë të ngritura, mund të vlerësohet që ka pasur disa organizime aktiviteteve dhe mbledhesh që kanë ofruar mundësinë e diskutimeve dhe konsultimeve me anëtarët respektivë të tryezave. Konsultimi i Planit Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2022 – 2024 me anëtarët e tryezave dhe marrja e rekomandimeve dhe komenteve sa i përket kapitujve dhe çështjeve të konsultuara në këto tryeza, ishte një hap pozitiv jo vetëm për procesin e konsultimit në tërësi, por sidomos kur kjo lidhet dhe me zhvillimet legjislativë dhe prioritetet në kuadër të procesit të integrimit evropian. Në vazhdim të këtij procesi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë organizoi një seri takimesh konsultuese në formatin online me të gjitha tryezat e PPIE që ajo koordinon, ku ofroi hapësirën e nevojshme për diskutim me të gjithë anëtarët e tryezave të saj.

Një shembull pozitiv vjen dhe nga Ministria Drejtësisë si institucioni koordinues për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore e cila gjithashtu mbledhi Tryezën e Diskutimit dhe Këshillimit për këtë kapitull, me qëllim prezantimin dhe diskutimin e prioritetëve dhe politikave të synuara nga PKIE 2022-2024, duke marrë komente dhe sugjerime me vlerë nga anëtarët e tryezës për Kapitullin 23. Një takim konsultues njëkohësisht përmbledhës dhe përmbyllës, u organizua nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme si institucioni kryesues i gjithë procesit të hartimit dhe miratimit të PKIE. Në këtë takim këshillues u ftuan dhe u bënë bashkë të gjithë anëtarët e të gjithë tryezave të ngritura të Platformës. Plani Kombëtar u miratua më pas, më 9 shkurt 2022. Anëtarët e Bordit të Platformës mund të zgjidhen vetëm pasi të gjitha Tryezat të jenë ngritur, në mënyrë që procesi i votimit dhe zgjedhjes të jetë i drejtë, ku të gjithë anëtarët të kenë të drejtë të zgjidhen dhe të zgjedhin përfaqësinë e tyre në Bord. Siç është parashikuar dhe në Urdhrin për ngritjen e Platformës, aktorët jo-shtetërorë dhe anëtarët e tryezave do të përfaqësohen në Bord nga vetë pjesëtarët të anëtarësisë së tryezave të PPIE. Formula e përcaktuar parashikon pesë sektorë[26]: 1. Shoqëri Civile, 2. Komuniteti i Biznesit, 3. Universitetet/Komuniteti Akademik 4. Partnerë Sociale (Shoqatat e Punëmarrësve) dhe 5. Autoritetet dhe Shoqatat Lokale – të cilët do të kenë dy përfaqësues si anëtarë të Bordit duke bërë të mundur që Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit të kenë 10 përfaqësues në total. Bordi është thelbësor në mënyrë që Platforma të arrijë të përmbushë funksionin e saj në tre plane – informimin, konsultimin dhe vendimmarrjen.

[26] Urdhri Nr. 113 i KM, datë 30.08.2019 "Për Format e Pjesëmarrjes, Funksionimin dhe Strukturën Institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian"- <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/01-Urdhri-i-KM-Nr.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

Vlerësimi i strukturave të konsultimit dhe zhvillimit të tyre

PLATFORMA E PARTNERITETIT PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Më konkretisht, nëpërmjet Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit (siç edhe emri i tyre nënkupton) ofrohet mundësia që të gjitha grupet e interesit të bëhen anëtare të këtyre tryezave në mënyrë që të informohen dhe të qëndrojnë të përditësuar mbi zhvillimet legjislativë në lidhje me hartimin apo miratimin e kuadrit ligjor, të zhvillimeve të kuadrit institucional, si dhe të konsultojnë dhe analizojnë dokumente strategjike, si dhe materiale që lidhen me procesin e shqyrtimit të legjislacionit dhe negociatave. Kjo mundëson që anëtarët e tryezave të jenë vazhdimisht të përditësuar dhe informuar mbi zhvillimet që lidhen me kapitujt e fushat e politikave ku ata janë pjesë.

Informimi nëpërmjet Platformës është i padiskutueshëm për të bërë të mundur që të arrihet funksioni i dytë i saj që është: konsultimi. Kjo nënkupton që anëtarët e tryezave nuk kanë vetëm mundësinë që të marrin pjesë dhe të informohen gjatë mbledhjeve dhe takimeve të organizuara, por edhe të drejtën dhe hapësirën për të diskutuar mes tyre dhe aktorëve shtetërorë përgjegjës të GNPIE, si dhe të japin komentet, sugjerimet dhe rekomandimet e tyre dhe organizatave që përfaqësojnë në lidhje me hartimin e draft politikave/apo projekt ligjeve të reja që prezantohen. Në këtë mënyrë, nëpërmjet Platformës objektivi kryesor është që ti përfshijë ata në mënyrë proaktive, ku anëtarët mundën dhe duhet të ofrojnë të gjitha inputet dhe sugjerimet e tyre, me synimin gjithashtu që këto rekomandime të merren në konsideratë nga institucionet përkatës. Ndërsa këto dy funksione apo objektiva të PPIE priten të përmbushen nga Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit, Bordi i Platformës synohet të realizojë një tjetër funksion të saj që është – vendimmarrja. Sa i përket akteve ligjore, dokumenteve, strategjive, raporteve apo çdo lloj publikimi tjetër të hartuar dhe publikuar në kuadër të bisedimeve me BE, Bordi ka të drejtën e tij që ti konsultoj këto dokumente, të japë komente dhe sugjerime dhe çfarë është dhe elementi më i rëndësishëm ti aprovojë ato, në mënyrë që procesi vendimmarrës të kalojë në fazat e mëtejshme. Ky do të jetë rasti edhe për hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Integrimit Europian. PKIE konsiderohet si dokumenti më i rëndësishëm strategjik sa i përket procesit të integrimit dhe më konkretisht të negociatave të Shqipërisë. Ai në fakt ndjek një proces deri diku të gjatë dhe të ndërlikuar të miratimit, ku shumë institucione janë të përfshira dhe kanë rolin e tyre, edhe pse rolin udhëheqës në të gjithë këtë proces e mban Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. Pas përfundimeve të të gjithë takimeve të konsultimit publik, PKIE me të gjitha rekomandimet e marra gjatë takimeve i dërgohet Bordit të Platformës për miratim. Pas këtij miratimi që duhet të vijë nga Bordi që gjithashtu mund të ketë komentet e tij, dokumenti mund të dërgohet për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për më tepër, të gjitha raportet, rekomandimet e nxjerra apo dokumente të tjera të realizuara në kuadër të organizimit të Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit, do të dërgohen pranë Bordit në mënyrë që kjo strukturë të jetë gjithnjë e informuar dhe e përditësuar mbi zhvillimet dhe përfundimet e tryezave të realizuara. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që Bordi të ketë mundësi të ndjekë procesin konsultues dhe të monitorojë nëse rekomandimet e nxjerra nga Platforma përputhen dhe merren në konsideratë nga institucionet përgjegjëse gjatë procesit vendimmarrës dhe miratimit të legjislacionit dhe politikave. Duke qenë që deri më tani nuk janë ngritur të gjitha Tryezat e Diskutimit dhe Këshillimit, Bordi nuk është funksional dhe Platforma nuk po e luan dot funksionin e saj të tretë – atë vendimmarrës.

Mekanizmat këshillues nga Kuvendi i Shqipërisë

I) KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN

Këshilli Kombëtar i Integrimit European konsiderohet si trupi më i lartë këshillues sa i përket procesit të integrimit në BE, i cili është krijuar me Ligjin Nr. 15/2015. Objektivi kryesor i tij është të promovojë dhe garantojë një bashkëpunim gjithëpërfshirës ndërmjet aktorëve politikë, institucioneve publike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, sa i përket procesit reformues në kuadër të integrimit në BE.

Anëtarësia e Këshillit përditësohet çdo dy vite, në kuadër të së cilës shpallen dy thirrje të hapura që synojnë dy sektorë kryesorë – Shoqërinë Civile dhe Median. Thirrjet e fundit janë publikuar në nëntor 2021 dhe qëndruan të hapura deri më 15 dhjetor 2021.[27] Vendimi për përzgjedhjen e aplikimeve si nga OSHC ashtu dhe nga media merret nga Kryetari dhe Zëv. Kryetari i KKIE. Pas përzgjedhjes së bërë në thirrjet e fundit, 14 OSHC janë ftuar për të qenë anëtare me një mandat dyvjeçar dhe me të drejtë vote në Këshill, ndërkohë që dy përfaqësues mediash kanë marrë statusin e të ftuarve të përhershëm në të gjitha takimet dhe mbledhjet e organizuara nga Këshilli Kombëtar i Integrimit European.

Këshilli momentalisht përbëhet nga 60 anëtarë[28] përfaqësues të një sërë institucionesh dhe organizatash. 26 prej tyre janë deputetë të Parlamentit e më konkretisht Kryetarë apo zëvendës kryetarë të Komisioneve Parlamentare dhe Kryetarë të Grupeve Parlamentare. Për më tepër, pjesë e Këshillit është dhe Ministri për Punët e Jashtme, Avokati i Popullit, përfaqësues nga zyra e Kryeministrit dhe Presidentit. Një tjetër grup përbën të ftuarit e përhershëm të Këshillit ku përfshihen përfaqësuesit nga Akademia e Shkencave, universitetet publike dhe jopublike, komuniteti i biznesit, shoqatat e punëmarrësve si dhe organizata ndërkombëtare dhe misionet diplomatike në Shqipëri. Përfaqësues të institucioneve të pavarura që raportojnë në mënyrë periodike pranë Kuvendit për funksionin dhe rolin e tyre si Komisioneri për të Drejtën e Informimit apo Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë gjithashtu anëtarë të Këshillit.

Çdo vit Këshilli përgatit planin e tij vjetor të aktiviteteve, ku është vënë re gjatë këtyre viteve që plani fokusohet vetëm në disa takime periodike me tema shumë të përgjithshme mbi integrimin european. Vetëm në 2022 me kalendarin e ri të aktiviteteve vihet re që takimet e planifikuara dhe ato tashmë të organizuara kanë pasur një fokus më tematik duke u përqendruar në një politikë apo çështje që lidhet me procesin e integrimit european të vendit. Bazuar në raportet vjetore të publikuara nga KKIE, gjatë 2021 janë organizuar vetëm 4 takime periodike dhe 3 aktivitete ndërgjegjëse. Takimet periodike kanë mbuluar tema shumë të gjera dhe të përgjithshme si hapja e negociatave, raportit i Komisionit European për Shqipërinë, roli i OSHC-ve në procesin e negociatave, dhe vetëm një prej këtyre takimeve ka pasur në shqyrtim një çështje tematike dhe specifike si bujqësia dhe siguria ushqimore.[29]

[27] Thirrja e Hapur për OSHC: <https://www.parlament.al/News/Index/15279> dhe Thirrja e Hapur për Përfaqësuesit e Medias: <https://www.parlament.al/News/Index/15264> publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit

[28] Anëtarësia e Këshillit Kombëtar të Integrimit European: <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/perberja2022.pdf>

[29] Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar të Integrimit European për vitin 2021: <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/raport2021.pdf>

Mekanizmat këshillues nga Kuvendi i Shqipërisë

I) KËSHILLI KOMBËTAR I INTEGRIMIT EUROPIAN

Aktivitetet për vitin 2022, nisën me një përbërje të re të Këshillit, teksa dy thirrjet e hapura për OSHC-të dhe median ishin mbyllur në dhjetor dhe përzgjedhja e aplikimeve kishte përfunduar. Gatë kësaj periudhe deri më tani janë realizuar dy takime, takimi i parë më 8 shkurt 2022^[31] mbi Planin Kombëtar të Integrimit European (i cili ishte i hartuar dhe në pritje të miratimit) dhe takimi tjetër me fokus punën përgatitore në lidhje me Konferencën e Parë Ndërqeveritare BE-Shqipëri. Ndërkohë, që janë realizuar dhe shpërndarë programet dhe ftesat për dy aktivitetet e radhës që do të organizohen në muajin maj 2022 me fokus progresin dhe procesin e implementimit të rekomandimeve të Komisionit European në dy kapituj themelorë – Kapitulli 23 – duke u përqendruar te progresi në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe Kapitulli 24 – duke u përqendruar te progresi në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar. Pavarësisht rolit dhe rëndësisë që kjo strukturë përmban, mund të vihen re disa kufizime të hasura që e ka ndaluar Këshillin të luajë në mënyrë efektive dhe të qenësishme rolin e tij si një organ këshillimor. Një prej këtyre kufizimeve lidhet drejtpërdrejt me numrin jo të lartë të aktorëve jo-shtetërorë që janë anëtarë të Këshillit – siç dhe është përmendur janë vetëm 14 OSHC dhe vetëm një përfaqësues nga universitetet, më konkretisht nga ai publik i Tiranës. Përfaqësues të universiteteve të tjera publike apo private të rajoneve të ndryshme të Shqipërisë nuk janë përfshirë. Sa i përket përfaqësimit rajonal, e njëjta gjë mund të thuhet dhe për përfaqësimin nga OSHC-të, kut të gjitha organizata anëtare në Këshill operojnë dhe kanë selitë e tyre në Tiranë, dhe Këshilli për momentin nuk ka asnjë OSHC lokale apo rajonale në anëtarësinë e tij. Pavarësisht këtij fakti, duhet përmendur që disa prej këtyre OSHC-ve kanë rrjetin e tyre të organizatave jo vetëm në Tiranë por edhe në rrethe të tjera.

Në lidhje me takimet dhe diskutimet që janë realizuar deri më tani, edhe kur ka pasur përpjekje për ti përqendruar në çështje tematike, problematika e hasur është që diskutimi orientohet vetëm në nivel politik, ku anëtarët e KKIE njëkohësisht deputetë në parlament e fokusojnë diskutimin vetëm në retorika e komente politike dhe heqin mundësinë për dialog konstruktiv e teknik, e ndër të tjera lënë shumë pak hapësirë ose aspak për përfshirje dhe kontribute nga aktorë të tjerë anëtarë të Këshillit, përfshirë këtu dhe Shoqërinë Civile. Ky devijim nga diskutimi përmbajtësor, sjell si pasojë që në të shumtën e rasteve të ofrohet një numër shumë i vogël rekomandimesh dhe komentesh me vlerë e interes, apo dhe të mungojnë fare.

Ndër të tjera, edhe pse Këshilli Kombëtar i Integrimit European raporton aktivitetet e tij në mënyrë të përvitshme dhe publikon përmbledhje të aktiviteteve të organizuara dhe në buletinet e tij informuese, mbetet e paqartë dhe nuk ka informacion mbi mënyrën sesi rekomandimet dhe kontributet e ardhura gjatë takimeve nga aktorë të shoqërisë civile por jo vetëm, përkthehen në funksionin dhe masat e ndërmarra nga parlamenti apo komisionet respektive parlamentare, apo dhe nga vetë Këshilli në lidhje me çështjet e diskutuara.

[31] Minutat e takimit mund të gjenden në këtë lidhje: <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Procesverbal%2008.02.2022.pdf>

Mekanizmat këshillues nga Kuvendi i Shqipërisë

II) PLATFORMA ONLINE “KONSULTIMI I PROJEKTLIGJEVE”

Kjo platformë online e krijuar rishtazi nga Kuvendi i Shqipërisë, ka si synim kryesor të garantojë parimin e transparencës në mënyrë që parlamenti të jetë sa më i hapur për publikun. Platforma online^[32] ngjashëm me Regjistrin Elektronik për Konsultimin Publik u ofron qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, ekspertëve dhe çdo grupi tjetër interesi të krijojnë një llogari dhe më pas nëpërmjet kësaj llogarie të kenë mundësi të kontribuojnë me komente dhe sugjerime për çdo projektligj që po konsultohet në Kuvend. Platforma synon të arrijë tre kategori grupesh që ftohen të konsultohen e të japin sugjerimet e komentet e tyre, më konkretisht: Organizata të Shoqërisë Civile (Jo-fitimprurëse apo Shoqata), Lobistët (ku përfshihen Fondacionet, Ekspertët apo Grupet e Interesit) dhe Individ (kategoria më e përgjithshme që i ofron mundësinë çdo qytetari të interesuar dhe të paangazhuar me asnjë nga dy grupet e tjera, të ketë mundësinë të regjistrohet dhe të kontribuojë në proces).

Gjithashtu, gjatë regjistrimit palëve të interesuara u jepet mundësia që të zgjedhin ato komisione parlamentare që lidhen më shumë me fushën e punës, interesin apo ekspertizën e vet aplikantëve. Ka tetë komisione parlamentare që mund të përzgjidhen, që përfshijnë këto çështje: Tregtinë dhe Mjedisin, Integrimin Europian, Politikën e Jashtme, Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, Ekonominë dhe Financat, Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Sigurinë Kombëtare, dhe Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Është përgjegjësi e këtyre Komisioneve që lidhet drejtpërdrejt me punën e tyre që të publikojnë në këtë platformë online ato projektligje me të cilat ata po punojnë, me qëllim që edhe në këtë fazë të procesit të konsultohen me grupe interesi. Rrjedhimisht, të gjitha projektligjet të shfaqura në faqen online janë të publikuara nga komisionet parlamentare përgjegjëse dhe nga komentet e sugjerimet që mund të merren nëpërmjet kësaj platforme online synohet që komisionet parlamentare të asistohen gjatë procesi analitik e legjislativ, si dhe gjatë miratimit të projektligjeve.

Kjo nismë është e një rëndësie të veçantë sa i përket rritjes së transparencës së punës së Kuvendit, si aktori kryesor ligjvënës në vend dhe gjithashtu për të fuqizuar bashkëpunimin ndërmjet këtij institucioni dhe sektorit të shoqërisë civile, por dhe grupeve të tjera të interesit. Pavarësisht rolit dhe funksionit që kjo platformë online synon të luajë e të realizojë, janë vënë re disa problematika apo sfida që ajo po has.

[32] Faqja zyrtare e Platformës ‘Konsultimi i projektligjeve’: <https://konsultimi.parlament.al/>

Mekanizmat këshillues nga Kuvendi i Shqipërisë

II) PLATFORMA ONLINE “KONSULTIMI I PROJEKTLIGJEVE”

Së pari, mungojnë komentet dhe kontributet në faqen online. Pas një studimi të detajuar të të gjithë projektligjeve të publikuara online, përfundimi është që nuk gjendet asnjë koment apo sugjerim i shkruar e i publikuar në një nga këto draft-ligje. Gjithashtu nuk ka të dhëna sa grupe interesi dhe aktorë të tjerë janë përfshirë, sa prej tyre janë bërë pjesë e platformës online, si dhe nuk ka informacion as për numrin e komenteve apo sugjerimeve të marra për secilin projektakt të publikuar. Nga mungesa e një informacioni të tillë, nuk është e qartë nëse kjo vjen për shkak të mungesës së interesit për tu përfshirë dhe për tu angazhuar, apo vjen pasi platforma online nuk është promovuar në mënyrën e duhur dhe informacionin rreth saj e ka vetëm një numër i vogël aktorësh.

Një tjetër element që duhet të dalë më mirë në pah dhe të qartësohet, sidomos për grupet e interesit dhe aktorët që mund të kontribuojnë në këtë proces konsultimesh, është vlera e shtuar dhe rëndësia që platforma online sjell, çfarë synon procesi i konsultimit në këtë fazë, dhe mbi të gjitha ndasia dhe dallimi nga roli dhe funksioni i Regjistrat Elektronik për Konsultimin Publik. Kështu duhet të sqarohet mbi të gjitha që këto dy nisma nuk mbivendosin apo zëvendësojnë njëra-tjetrën, pasi proceset e konsultimit ndodhin në faza të ndryshme të hartimit të projektligjit.

Marrë në konsideratë që procesi legjislativ kalon në disa faza, secila prej tyre ka rëndësinë e saj dhe secila prej tyre duhet të monitorohet në mënyrë të kujdesshme. Nga ana tjetër aktorët e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë mund dhe duhen të përfshihen në më shumë se në një fazë të procesit politikëbërës dhe vendimmarrës. Në këtë mënyrë, procesi i konsultimit i realizuar me institucionet publike hartuese të projekt-aktit ka rëndësinë dhe peshën e saj në proces, po aq sa ka dhe procesi konsultues me autoritetet legjislative të cilat i analizojnë këto projektakte dhe në fund i miratojnë ato. Të dyja këto faza kanë të njëjtat qëllime e objektiva – të arrijnë transparencën, të përfshijnë aktorët e interesuar dhe të realizojnë një proces informimi dhe konsultimi gjithëpërfshirës. Por, duke qenë që procedura e konsultimit kalon në shumë faza dhe jo gjithmonë njihen në detaje nga qytetarët apo dhe aktorët e tjerë, ekziston rreziku që konsultimi publik me Kuvendin të shihet si një përsëritje e procesit konsultues me institucionet e tjera hartuese, dhe në këtë mënyrë të mos merret në konsideratë nga aktorët duke bërë që ata të mos përfshihen fare në këtë fazë të procesit.

Rekomandimet e shoqërisë civile për procesin e konsultimit

Drejtuar strukturave shtetërore dhe platformave të konsultimit

#1

Performanca institucionale për konsultimin publik duhet të përmirësohet përmes ndjekjes së plotë të procedurës dhe metodologjisë për një proces konsultimi efektiv dhe të suksesshëm dhe monitorimit periodik të Planit të Veprimit për Konsultimin Publik.

#2

Institucionet duhet të respektojnë kohën e parashikuar me ligj për hapjen dhe mbylljen e procedurës së konsultimit publik, ndërkohë që duhet të ketë një larmishmëri të mjeteve që përdoren për informimin dhe promovimin e këtij procesi. Publikimi në faqen zyrtare të institucionit është i domosdoshëm, por nuk mjafton. Mjete të tjera duhet të përdoren për informimin e grupeve dhe palëve të interesuara si: komunikimi përmes e-maileve, aktivitetet publike dhe sesionet informuese, ftesave të drejtpërdrejta të grupeve të interesit, përdorimi i medias tradicionale etj.

#3

Takimet konsultuese nuk duhet të organizohen vetëm në Tiranë, edhe pse aty janë selitë e të gjitha institucioneve kryesore. Mundësia për të qenë pjesë e këtyre takimeve dhe konsultimit publik duhet t'u ofrohet dhe OJF-ve jashtë Tiranës në mënyrë që ato të përfshihen në proces dhe të informohen për zhvillimet e fundit, me fokus kryesor procesin e integritetit në BE.

#4

Institucionet duhet të organizojnë trajnime dhe aktivitete të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve në bashkëpunim të ngushtë me aktorë dhe ekspertë jo-shtetërorë në lidhje me njohjen më të mirë dhe përmirësimin e procedurave të konsultimit të ndjekura nga institucionet, duke ofruar praktikatat dhe shembujt më të mirë nga BE-ja dhe nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Theksi duhet vënë në metodologjinë dhe procesin e monitorimit të performancës së institucionit.

#5

Rritja e ndërgjegjësimit përmes fushatave informuese për procesin e integritetit në BE, duke analizuar dhe demonstruar qartë rolin e aktorëve të shoqërisë civile në proces. Kjo është thelbësore për të informuar të gjithë aktorët për procesin dhe strukturat përkatëse, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i njohin dhe më pas të përfshihen.

Rekomandimet e shoqërisë civile për procesin e konsultimit

Drejtuar strukturave shtetërore dhe platformave të konsultimit

#6

Regjistri Elektronik për Konsultimin Publik dhe platforma online për “Konsultim të Projektligjeve” duhet të përmirësohen dhe të përfshijnë më shumë të dhëna dhe informacion jo vetëm për projektligjet dhe dokumentet që do të konsultohen, por edhe informacione të tjera të dobishme dhe praktike për t'u përdorur dhe për t'u përpunuar nga institucionet shtetërore, studiuesit dhe grupet e tjera të interesit si: publikime, raporte, të dhëna statistikore etj.

#7

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet Platformës së Partneritetit për Integrimin Europian dhe mënyrës sesi procedura dhe standardet e konsultimit publik duhet të ndiqen gjatë takimeve në kuadër të Platformës. Duhet të vendoset gjithashtu një lidhje ndërmjet platformës dhe regjistrit elektronik.

#8

Është e nevojshme të krijohet një faqe interneti interaktive online e koordinuar nga Platforma e Partneritetit për Integrimin Europian dhe që të përditësohet me dokumente, përmbledhje, raporte që nxirren gjatë Tryezave të Diskutimit dhe Këshillimit. Kjo do të rrisë transparencën dhe do t'u japë mundësinë të gjithë aktorëve dhe palëve të interesuara të kenë informacion se si po shkon procesi. Anëtarët e tryezave të konsultimit duhet të jenë në gjendje të kontribuojnë gjithashtu me dokumente dhe raporte të ndryshme në lidhje me fushat e tyre të interesit dhe ekspertizës.

#9

Procesi duhet të karakterizohet nga transparenca që do të thotë se të gjitha dokumentet dhe aktet që do të konsultohen si dhe raportet e tjera pasuese duhet të jenë publike dhe duhet të ndahen me të gjithë aktorët e vlerësuar si të rëndësishëm për t'u angazhuar në procesin e konsultimit.

#10

Duhet të përgatitet dhe përditësohet një metodologji identifikimi dhe monitorimi për kontributet që merr çdo institucion gjatë procesit të konsultimit. Kjo metodologji duhet të përkthehet në analiza dhe raporte për të ndihmuar strukturat përkatëse dhe palët e interesuara që të marrin masa për të përmirësuar performancën.

Rekomandimet e shoqërisë civile për procesin e konsultimit

Për aktorët e Shoqërisë Civile

#1

Për një proces konsultimi efektiv dhe frytdhënës nevojitet një numër i lartë pjesëmarrësish të përfshirë dhe të informuar. Ata duhet të luajnë një rol aktiv dhe të marrin pjesë me komentet dhe sugjerimet e tyre. Në rastin e anëtarëve të tryezave të këshillimit të PPIE, edhe pse është e rëndësishme që anëtarësia e tyre të përditësohet dhe të zgjerohet në të ardhmen, aktorët që janë pjesë duhet të jenë aktivë dhe të kontribuojnë gjatë takimeve.

#2

Jo të gjitha OSHC-të kanë kapacitetet dhe informacionin e nevojshëm, megjithatë ato duhet të jenë pjesë e procesit. Në rastet kur temat janë shumë teknike ose mungon ekspertiza në mesin e përfaqësuesve të OSHC-ve, trajnimet dhe mbështetja duhet të sigurohet përmes bashkëpunimit me sektorët e tjerë dhe me homologët e tyre në vende të tjera. Në këtë drejtim, ata do të rrisin kapacitetet e tyre dhe do të mund të kontribuojnë gjatë procesit të konsultimit me informacione të vlefshme.

#3

Duhet të organizohen trajnime të përbashkëta të strukturave shtetërore dhe përfaqësuesve të OSHC-ve, duke synuar ato që veprojnë në nivel lokal ose që nuk kanë kapacitetet e mjaftueshme. Në këtë mënyrë organizatave u ofrohen sugjerimet përkatëse mbi procesin e Bashkimit Europian, Integritetit dhe Negociatave në BE dhe më e rëndësishmja mbi strukturat dhe platformat e diskutimit dhe konsultimit ku kontributet e tyre janë shumë të mirëpritura dhe të nevojshme.

#4

Duhet të ulet skepticizmi dhe qëndrimi jo-bashkëpunues në marrëdhënie me institucionet shtetërore gjatë procesit të konsultimit. Duke qenë se institucionet shtetërore në shumicën e rasteve priren të mos përparojnë me procesin, për shkak të detyrave të tjera dhe ngarkesës së madhe, roli i OSHC-ve duhet të jetë mbështetës dhe më fleksibël që ta shtyjë më tej këtë bashkëpunim.

#5

Është e nevojshme të rritet koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore për shpërndarjen e informacionit dhe rezultateve të këtij procesi.

Bibliografia

Faqja zyrtare e Bashkimit European:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/policy-highlights/civil-society_en

Faqja zyrtare e Parlamentit shqiptar:

<https://www.parlament.al/DokumentaIntegrimi?integrimId=7>

Faqja zyrtare e Platformës online të Kuvendit 'Konsultimi i projektligjeve':

<https://konsultimi.parlament.al/>

FATF për Shqipërinë: <https://www.fatf-gafi.org/countries/#Albania>

https://qbz.gov.al/share/_ftuk3bSSBGcUkuVLwUVWA

Komisioni European (2020), Metodologjia e Re e Zgjerimit - Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor::

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/enlargement-methodology_en.pdf

Ligji Nr. 146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik":

<https://dpttv.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/Per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik.pdf>

Ligji Nr. 80/2021 për regjistrimin e OJF-ve:

<https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/08/ligj-nr.-802021-dt.-24.6.2021.pdf>

Lista e Kapitujve të Acquis së BE: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en

Përfundimet e Këshillit për Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizim Asociimit - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Shqipërisë, 25 mars 2020:

<https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

Raportet Vjetore të Transparencës të publikuara nga autoritetet publike në regjistrin elektronik:

<http://www.konsultimipublik.gov.al/Raporte2021>

Raporti i konsultimit publik për projektligjin për regjistrimin e OJF-ve:

https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_272_Raporti%20i%20Konsultimit%20Publik%20per%20OJF.docx

Raporti i performancës për Konsultimin Publik: Performance Report on Public Consultation (Gjysma e parë e 2021):

https://konsultimipublik.gov.al/documents/reports/RaportiiPerformancesKonsultimitPublik_CoG_30.07.2021.pdf

Raporti vjetor i Këshillit Kombëtar i Integritetit European për vitin 2021:

<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/raport2021.pdf>

Bibliografia

Raporti vjetori i Komisionit Europian: Shqipëri 2020:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

Raporti vjetori i Komisionit Europian: Shqipëri 2021:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Regjistri Kombëtar Elektronik për Konsultimin Publik:

<https://konsultimipublik.gov.al/>

Shoqëria Civile në Integrimin në BE të Ballkanit Perëndimor:

<https://www.files.ethz.ch/isn/184325/Civil%20Society%20in%20the%20EU%20Integration%20of%20the%20Western%20Balkans.pdf>

Urdhri Nr. 113 i KM, datë 30.08.2019 "Për Format e Pjesëmarrjes, Funkcionimin dhe Strukturën Institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian" -

<https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/01-Urdhri-i-KM-Nr.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

VKM Nr. 422, datë 6.5.2020 "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" -

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/98/9627cbf1-a528-4e11-8a6a-597b16cfaae2>

VKM Nr. 746 datë 09.12.2021 mbi disa ndryshime për Vendimin Nr. 422, datë 6.5.2020 "Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", i ndryshuar -

<https://kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-9-dhjetor-2021/>

VKM Nr. 94 datë 20.05.2019 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve

Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian" - [http://integrimi-ne-](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/1.-Urdher-i-KM-no.94-dt.20.05.2019-per-GNPIE.pdf)

[be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/1.-Urdher-i-KM-no.94-dt.20.05.2019-per-GNPIE.pdf](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/1.-Urdher-i-KM-no.94-dt.20.05.2019-per-GNPIE.pdf)

VKM Nr.749, datë 19.12.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian." -

<http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/0-VKM-no.749-dt.19.12.2018-Krijimi-i-strukturave.pdf>

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile



info@resourcecentre.al



www.resourcecentre.al